



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1032/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Ruzhdi Kryeziut kandidat për kuvendin komunal në Malishevë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Ruzhdi Kryeziut kandidat për kuvendin komunal në Malishevë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë për vendvotimet: 3001A/03D; 3001A/02R; 3038A/02D; 3038A/01R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel më datë 10.11.2017 në ora 12:00 nga Ruzhdi Kryeziut kandidat për kuvendin komunal në Malishevë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë në të cilin pretendon se ka mungesa të votave nga vendvotimet 3001A/03D; 3001A/02R; 3038A/02D; 3038A/01R

Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i që ky apel të pranohet si i bazuar dhe ti urdhërohet KQZ-së që të vërtetojë gjendjen e saktë faktike

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, për faktin se pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës si dhe dëshmimeve të ofruara nga ankuesi që gjenden në shkresat e lëndës dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga vendimi i KQZ-së me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit për vendvotimet e lartcekura si më lart, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*

Nga sa u tha me sipër ne mbështetje te nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së,u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL A nr. 1032/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.